

Ky veprim minon shpresën e bashkekzistencës së feve

Në lidhje me vendimin e Turqisë për të kthyer në xhami Kishën e Urtësisë së Perëndisë (“Shën Sofinë”), Kryepiskopi i Tiranës, Durrësit dhe i Gjithë Shqipërisë, Anastasi, deklaroi:

“Ky vendim bën pjesë në ato veprime tragjike, të cilat minojnë shpresën më të madhe të epokës sonë, që është bashkekzistenca e feve dhe qytetërimeve.

Ky vendim na kthen pas, në aspekte të errëta të historisë. Një vend si Turqia, që dëshiron të jetë pararojë, zgjedh rolin e praparojës së vonuar kulturore. Është mëkat edhe gabim kur vaji i fesë përdoret për të ndezur dhe për t’i shërbyer qëllimeve nacionaliste. Qëllimi fisnik i fesë është të qetësojë plagët dhe të paqësojë shpirtrat e njerëzve.”

11.07.2020



Kisha e Shën Sofisë

Më 27 dhjetor 537, perandori Justinian dhe perandoresha Theodhora përuruan Katedralen e Shën Sofisë. Kur hyri në kishë, Justiniani u mahnit aq shumë nga bukuria e saj, sa thuhet se deklaroi: “Solomon, unë ta kalova”, duke e krahasuar me Tempullin e Solomonit dhe tempullin e 2-të Jerusalemit, që u shkatërrua nga romakët në vitin 70 pas Krishtit. Kjo katedrale, për më shumë se 1000 vjet, ka qenë katedralja më e madhe në botë.

Kori i “Shën Sofisë” në shek. VII kishte 160 psaltë. Stafi i klerikëve të “Shën Sofisë” në shek. XII arriti në 700 persona, duke përfshirë dhe dhjakët. Ajo mbante gjatë shërbesave mbi 16.000 persona.

Katedralja e Shën Sofisë është perla e arkitekturës bizantine. Ndërtimi i saj filloi më 23 shkurt 532. Punimet u kryen nën kujdesin e gjeometrit dhe inxhinierit grek, Isidorit të Miletit dhe matematicienit Anthemit i Tralës. Ishte e gjatë 82 m, e gjerë 73 m dhe e lartë 55 m.

Katedralja u kthye në xhami ditën e rënies së Konstandinopojës, në vitin 1453, nga Mehmeti II dhe në muze në vitin 1935, nga Ataturku.

Një lloj “xihadi” kulturor

Deklaratë e re e Kryepiskopit Anastas për Kishën e Shën Sofisë (18. 7. 2020)



Vendimi i pakthyeshem i Turqisë rreth “Shën Sofisë” nuk është vetëm një lloj “xihadi” (luftë e shenjtë) kulturor, veçanërisht sot kur çdo lloj xihadisti dënohet ndërkombëtarisht nga të gjithë, por është një fyerje si ndaj Krishterimit, ashtu dhe ndaj Islamit.

Bënë xhami Kishën e mrekullueshme të Krishterimit të pandarë dhe po përpiqen të mbulojnë fytyrën e saj shumë të bukur dhe të zhvlerësojnë ikonat e saj të mrekullueshme, sytë e saj shprehës.

Për më tepër, po përurojnë edhe një lloj xhamie krejt të pazakontë për Islamit klasik, me ikona të krishtera të mbuluara, të cilat, brenda “heshtjes elokuate” të tyre, nuk reshtin së dëshmuari të vërtetën e krishterë. Nuk e di nëse ka ndonjë vend islamik lutjeje të ngjashëm në botë.

Intrasigjenca e autoriteteve turke nënvizon atë që theksojmë gjatë dhjetëvjeçarëve të fundit: Dhuna në emër të fesë dhuron shenjtërinë e vetë fesë. Dhe askush, sado i fuqishëm dhe i madh të mendojë se është, nuk ka të drejtë ta përbuzë këtë të vërtetë mbarënjerezore.

* Fortlumturia e Tij, Kryepiskopi i Tiranës, Durrësit dhe i Gjithë Shqipërisë, Anastasi, është anëtar nderi i Akademisë së Athinës, Profesor Emeritus i Historisë i Universitetit Kombëtar Kapodistrian të Athinës dhe President Nderi i “Konferencës Botërore të Feve për Paqe”.



Ta ndërtojmë jetën mbi themele të forta

Jeta në vendin tonë, në shoqërinë tonë do të ishte krejt ndryshe nëse do të ishte themeluar dhe ndërtuar mbi parimet dhe mësimet e krishtera.

Në vitet 90-të, vite të ndryshmeve të mëdha për vendin tonë, u mbyllën rreth 500 fabrika dhe uzina, duke humbur punën qindra mijëra punonjës dhe duke shkaktuar një dëm të rëndë ekonomik jo vetëm për ato vite, por edhe për gjithë vazhdimësinë e shtetit shqiptar, me pretekstin “t’i prishim se do të na i ndërtojë të reja bota dhe Amerika”. Kanë kaluar 30 vjet dhe uzina “Gogo Nushi” në Azotik, ku punonin 3000 punonjës, ka mbetur e shkretë dhe e rrënuar.

Njeriu më revolucionar i historisë së njerëzimit mbetet Krishti e, megjithatë, Ai nuk na mëson se çdo gjë e vjetër është e keqe dhe duhet prishur. Kështu dëgjuam sot në pjesën e Ungjillit që na thotë: “Mos kujtoni se erdha të hedh poshtë ligjin a profetët. Nuk erdha të hedh poshtë, po të përmbush.” (Shih. Matth. 5:17). Krishti, ndonëse erdhi të sjellë një Ligj të Ri, të krijojë një Besëlidhje të Re me njeriun, nuk hedh poshtë Ligjin

e Vjetër, por e plotëson, e përsos atë. Nga “mos vrit” që thuhej në ligj, Krishti mëson se jo vetëm “të mos vrasim”, por as të mos i themi vëllait tonë “i marrë”. Na mëson jo vetëm “të mos vjedhim”, por të ndihmojmë ata që janë në nevojë. Të duam jo vetëm bashkëkombësit tanë, por edhe armiqtë tanë.

Kështu veprroi Krishterimi me të vërtetë. Mori dhe ruajti disa nga mësimet e Ligjit, e dimë që 10 porositë që mori Moisiu në Malin Sina, vazhdojnë të kenë rëndësi. Gjithashtu, ruajti edhe nga traditat judaike, duke u dhënë kuptim të ri, duke hequr vetëm disa aspekte që nuk ishin të nevojshme. Tradita e dhënies së emrit në ditën e tetë dhe ajo e hyrjes së fëmijës me nënën në tempull, dyzet ditë pas lindjes, ruhen edhe sot. Hoqi p.sh.: rrethprerjen, sepse me Pagëzimin ne jemi vulosur me vulën e Shpirtit të Shenjtë. Gjithashtu hoqi flijimet, sepse Krishti u bë flijimi i përsosur për gjithë njerëzimin.

Nuk është pra e nevojshme, të zhdukim çdo gjë që është e vjetër në emër të së resë. Një thënie e urtë thotë: “Mos e prish kolibën e

atit tënd para se të kesh ndërtuar vilën tënde”. Zakonisht, ndodh që, kur duam të marrim një vendim, nuk na thonë që shko pyet një bashkëmoshatar, por shko pyet një të moshuar, të urtë, të ditur.

Në Shkrimin e Shenjtë tregohet një ngjarje në popullin e Izraelit. Pas vdekjes së Solomonit, në krye të mbretërisë erdhi i biri. Ai ishte një djalë i ri. Një ditë i vajtën disa nga pleqtë e popullit të Izraelit dhe i thanë: “Tani, ju lutemi, na i lehtëso disa taksat dhe ne do të të ndjekim pas ashtu siç ndoqëm atin tënd”. “Mirë, largohuni, dhe pas disa ditësh do t’ju kthej një përgjigje” - u tha mbreti i ri. Ai mbledhi këshilltarët, pleqtë e urtë, me të cilët këshillohej edhe Solomoni, babai i tij, dhe i pyeti se çfarë do të bënin. Ata i thanë: “Dëgjoje popullin tënd, lehtësojua taksat, sepse janë të larta, që ata të të ndjekin”.

Mbreti shkoi të pyeste dhe bashkëmoshatarët e tij. Ata i thanë, jo vetëm mos t’i ulte taksat, por t’i rriste akoma më tepër. Pas disa ditësh, të gjithë po prisnin vendimin e mbretit. Ai iu tha atyre: “Unë do t’ju rris akoma

më tepër taksat”. Mbreti kishte dëgjuar këshillën e shokëve të tij, jo të këshilltarëve të urtë e të moshuar. Atëherë, pleqtë e fiseve të Izraelit u larguan dhe kështu mbreti humbi 10 fise nga mbretëria e tij, të cilët nuk e ndoqën më.

Kur e reja gërshetohet me të vjetrën, bëhet potencial i fuqishëm dhe shpresëdhënëse për të tashmen dhe të ardhmen. Kur zhvillimi i teknologjisë gërshetohet me mësimet e Krishterimit, ajo bëhet një dinamikë e pathyeshme dhe e pagabueshme për shoqërinë tonë.

Pavarësisht se në shoqërinë e sotme mësimet e krishtera i quajmë të prapambetura, le ta themelojmë jetën tonë mbi këtë shkëmb.

Le të kujtojmë dhe fjalët e Krishtit: “Kushdo, pra, që dëgjon këto fjalët e mia edhe i bën ato, do ta përngjaj atë me një njeri të mençur që ndërtoi shtëpinë e tij mbi shkëmb”. (Shih. Matth. 7:24).

Nga Mitropoliti i Apollonisë dhe Fierit, Hirësi Nikolla, dt.19 korrik 2020.



Në datën 14 korrik, Mitropoliti i Apollonisë dhe Fierit, Hirësi Nikolla, kreu Liturgjinë Hyjnore në kishën e Shën Trifonit, në fshatin Sheqishte. Përpara së kremtes, me kontributin e besimtarëve, u bënë rregullime me vlerën 350 mijë lekë, si shtrimi i kishës me pllaka, rregullimi i varrit të shenjtorit etj.

Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë në ndihmë të qindra familjeve të prekura nga tërmeti

Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë, në kuadër të aktiviteteve humanitare, ka iniciuar nismën për të qenë pranë qindra familjeve në nevojë. Ky projekt ka nisur me ndihmën për 50 familje të fëmijëve jetimë të zonës së tërmetit në rrethin e Kurbinit, si edhe për shumë familje të tjera në gjendje të vështirë ekonomike të zonës së Kurbinit, Durrësit dhe Tiranës, të prekura dhe nga tërmeti i nëntorit 2019, si dhe të vë në dhe më shumë në vështirësi për shkak të përhapjes së virusit Covid-19 në vendin tonë.

Ky projekt humanitar vjen si një bashkëpunim i Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë me partnerë ndërkombëtarë, siç është organizata më e madhe botërore në fushën e paqes dhe dialogut, akredituar dhe nga OKB-ja, "Religions for Peace", me qendër në New York, SHBA.

Projekti i shtrirë në zonat e lartpërmendura dhe në fshatrat e tyre, po zbatohet nga të rinjë të reja myslimane e të krishtera, anëtarë të Departamentit të Gruas dhe Departamentit të Rinisë në Këshillin Ndërfetar të Shqipërisë, të cilët, njëkohësisht, përfaqësojnë edhe pesë komunitetet tradicionale fetare në Shqipëri, dhe që bashkëdrejtajnë edhe Qendrën e Këshillit Ndërfetar.

Nisma është çelur me shpërndarjen e ndihmave për familjet e

jetimëve në Laç, aktivitetet i zhvilluar nga KNFSH-ja në bashkëpunim me Shoqatën Kombëtare të Jetimëve të Shqipërisë.

Në këtë aktivitet morën pjesë përfaqësues të komuniteteve fetare, drejtues të bashkisë Kurbin, shoqërisë civile dhe përfaqësues të medias. Më pas, vullnetarët e rinisë së KNFSH-së vazhduan me shpërndarjen e pakove ushqimore nëpër shtëpitë dhe familjet në nevojë në Kurbin, Durrës dhe Tiranë.

KNFSH-ja tashmë është në ndjekje të disa projekteve me karakter humanitar, social, kulturor dhe, më gjerë, në kuadër të bashkëpunimit ndërfetar, duke rritur kapacitetet e aktivizimit të grave dhe të të rinjëve myslimane e të krishterë, si fuqi e ndryshimit pozitiv dhe promovimit të dialogut ndërfetar në Shqipëri dhe përtej saj.

Genti Kruja



Në ndihmë të Kishës dhe qytetarëve të Gramshit

Me bekimin e Kryepiskopit Anastas dhe nën kujdesin e Mitropolitit të Elbasanit, Andonit, Zyra e Rinisë e Kryepiskopatës, në bashkëpunim me Zyrën e Fëmijëve të Tiranës dhe Zyrën e Katekizmit të Mitropolisë së Elbasanit, nga data 16 - 19 korrik 2020, ndërmoren nismën nën logon "Shërbim, Ofrim dhe Shpresë".

Falë nismës u mundësua lysterja nga jashtë e gjithë kishës

"Metamorfoza e Shpëtimtarit", me sipërfaqe rreth 1200 m² dhe e kambanores, me sipërfaqe rreth 300 m². Gjithashtu, u lye kangjellat, si edhe u realizua ndriçimi tërësor i mjediseve të jashtme.

Ndërkohë, për fëmijët që ndjekin mësimet e katekizmit, u përgatit një program i veçantë triditor, me temë: "Hyjlindësja Mari, Nëna e gjithë njerëzimit".

Kapitull i veçantë ishte ndihma për familjet në nevojë. Përveç ndihmave ushqimore, u ndërhy në restaurimin e dy shtëpive, që rrezikonin shembjen.

Për të parë nga afër këto aktivitete e për të kryer Liturgjinë, ditën e diel, më 19 korrik, në qytet erdhi Hirësi Andoni, i cili u njoh me të gjitha zhvillimet e këtyre ditëve.

Pas Liturgjisë Hyjnore, Hirësi Andoni vëzhgoi punimet dhe vizitoi nga afër shtëpinë e restauruar. Ai inkurajoi familjarët dhe i siguroi ata se Kisha nuk do t'i braktisë dhe do të jetë gjithmonë pranë tyre.

Nuk mund të lëmë pa përmendur donatorët dhe dhuruesit që ofruan, për ta bërë realitet këtë nismë, e cila do të pasohet së shpejti edhe nga të tjera:

- Kryepiskopin e Tiranës, Durrësit dhe të Gjithë Shqipërisë, Anastasin, si edhe Mitropolitin e Elbasanit, Andonin.

-Miqte e Famullisë së kishës "Metamorfoza e Shpëtimtarit", VONO Apeldoorn, Holandë, me përfaqësues z. Jaap Kappers.

-Miqte tanë Marien dhe Serafinin.

Gjithashtu, mirënjohje të veçantë shprehim për Bashkinë e qytetit të Gramshit, me drejtues z. Klodjan Taçe, i cili u interesua personalisht për mbarëvajtjen e punimeve që u kryen këto ditë, duke na lehtësuar të gjitha procedurat.

Falënderojmë edhe të gjithë mjeshtrit, të cilët punuan me përkushtim.

Gjithashtu, falënderojmë ngrohësisht edhe besimtarët e devotshëm të qytetit, të cilët hapën dyert e shtëpive të tyre, duke na strehuar të gjithë për sa ditë qëndruam atje.

Joan Meni



Krishterimi në Arabinë Saudite

Kisha në foto i përket shek. IV dhe ndodhet ne qytetin Jubail të Arabisë Saudite. Rrënojat e kësaj kishe u zbuluan në vitin 1986 dhe, që prej asaj dite, askush nuk lejohet ta vizitojë, qoftë i huaj apo vendas, si edhe nuk lejohen të bëhen kërkime arkeologjike në këtë zonë.

Të krishterët kanë pasur kishat e tyre në Arabi që para shek. IV. Disa vende te Arabisë kanë qenë tërësisht të krishtera, p.sh. qyteti Najran, i cili deri në shek. X ka qenë me popullsi dominuese të krishterë. Më pas, shumica e këtyre banorëve u detyruan të largoheshin nga vendi dhe ajo pjesë që mbeti, qëndroi si kriptokristiane. Por persekutimi nuk reshiti – p.sh. më 15 qershor të vitit 1858, 21 banorët e mbetur të krishterë të qytetit Xhedah në Arabi, u masakruan të gjithë. Arabia Saudite i lejon të krishterët të vizitojnë vendin e tyre si turistë apo për punë, por i ndalon

të mbajnë me vete Bibla, ikona apo dhe kryqe. Mutaween (ose e njohur dhe si Policia Fetare) ndalon praktikimin e çdo religjioni tjetër në Arabi, përveç atij Islam. Kjo do të thotë që, nëse dikush është i krishterë, nuk ka të drejtë ta praktikojë besimin e tij. Gjithashtu, qeveria arabe nuk i lejon klerikët e krishterë të hyjnë në vend dhe të mbajnë një shërbesë ose të

takojnë ata banorë që ende kanë mbetur të krishterë.

Sipas raportit të vitit 2015, janë mbi 60 mijë të krishterë që jetojnë në vend (pa përfshirë këtu emigrantët ekonomikë, kryesisht nga Azia), të cilët janë kriptokristianë. Në Arabinë Saudite nuk ka asnjë kishë, qoftë Ortodhokse, Katolike apo tjetër. Takimet e të krishterëve në Ara-

bi bëhen në mënyrë të fshehtë, që të mos rrezikojnë jetën. Edhe praktikimi i riteve fetare bëhet në mënyrë të fshehtë, në shtëpitë e tyre.

(Referuar masakrës së qytetit Xhedah, më 15 qershor 1858, The Church of England quarterly review, 1858 p. 218-219).

Përgatiti: Kostandin Luci



Deklaratë e QBNF-së, Elbasan në lidhje me shpifjet dhe cenimin e dinjitetit të Imzot Andon Merdanit

Jemi të shqetësuar dhe të indignuar nga akuzat e pabaza dhe shpifjet e pamoralshme që individit Foti Cici, i vetëquajtur atë, me banim në Kanada, vazhdimisht poston në faqen e tij të Facebookut kundër klerikëve të lartë dhe të tjerëve të Kishës Ortodhokse në Shqipëri.

I tillë është edhe postimi i tij i fundit, para disa ditësh, kundër Mitropolitit të Elbasanit, Shpatit dhe Librazhdit, Imzot Andonit (Merdani), për të cilin të gjithë, si besimtarët dhe klerikët ortodhoksë, ashtu edhe ata të besimeve të tjera ruajnë vlerësimet më të mira për përgatitjen e tij fetare dhe intelektuale, karakterin e tij

moral dhe shoqëror, si dhe për angazhimet dhe kontributin e tij në bashkëpunimin ndërfetar në vite.

Ne, si Qendër e Bashkëpunimit Ndërfetar në Elbasan, shprehim solidaritetin e plotë dhe mbështetjen tonë ndaj këtij kleriku të lar-

të dhe njëkohësisht ngremë shqetësimin tonë për cilësinë e medias dhe të profesionalizmit gazetarësh, si dhe të organeve shtetërore kompetente që fenomene të tilla të shëmtuara të mos përsëriten, por të merren masa për ndëshkimin e

atyre personave dhe grupimeve, të cilët, me veprimet e tyre, vënë në rrezik jo vetëm lirinë e fjalës, por dhe vetë vlerën e harmonisë ndërfetare që gëzon vendi ynë.

Elbasan, 2 korrik 2020



Anargjendët mrekullibërës

Z. Vassilios Kekis, profesor i Kirurgjisë në Universitetin e Athinës dhe Drejtor i Kirurgjisë në Qendrën Mjekësore të Athinës, përjetoi në Boston, SHBA, në vitin 1962, një përvojë të fortë fetare, në lidhje me trajtimet mrekullibërëse të Shenjtorëve Anargjendë, të cilat po i paraqesim më poshtë, siç i tregoi ai vetë, për lavdinë e Zotit dhe për nder të shenjtorëve Kozma e Damian:

Në maj të vitit 1962, në Spitalin Publik të Massachusetts-it në Boston, sollën me urgjencë një djalë 12-vjeçar, të cilit i qe këputur dora e djathtë në një aksident. Pas një operacioni të suksesshëm, gjymtyra u rivendos dhe, pas njëfarë kohe djaloshi u kthye në ekipin e bejsbollit të shkollës së tij. Pas këtij suksesi, shtypi i përditshëm dhe periodik amerikan dëshironte të merrte detaje në lidhje me ngjarjen dhe prandaj, nga spitali, u organizuan konferenca për shtyp me kirurgët që morën pjesë në këtë ndërhyrje të vështirë. Para së gjithash, një nga gazetarët e pyeti nëse Spitali Publik i Massachusetts-it pretendonte përparësi për një operacion të tillë.

Atëherë, për habinë e të gjithëve, drejtori i spitalit, kirurgu E. D. Churchill, u përgjigj: “Jo, ne nuk



pretendojmë një përparësi të tillë, sepse një grup tjetër mjekësh, Shenjtorët Kozma dhe Damian, rreth vitit 400, prenë këmbën e gangrenizuar të një burri dhe ia zëvendësuan me këmbën e shëndetshme të një arabi, i cili sapo kishte vdekur. Revista “M. G. H.” botoi më pas një pikturë të shekullit XIV me titull “Mrekullia e këmbës së zezë” nga shenjtorët Kozma e Damian.

Revista mjekësore “Spectrum” e kompanisë “Pfizer”, duke dashur të botonte një imazh me ngjyra të mrekullisë, zbuloi se në muze ekzistojnë më shumë se 1.500 piktura të kohës së Rilindjes dhe kisha të ndryshme në Europë, të cilat ikonizojnë transplantin e një gjymtyre nga shenjtorët Kozma dhe Damian. Këto piktura vizitori mund

t’i gjejë sot në Muzeun e Shën Markut në Venecia, Itali. Shumë të tjera janë në Galerinë e Mynihut, në Akademinë e Firences, në Luver në Paris dhe në kisha të ndryshme në Europë. Dhe në Greqi, në kishën e Shenjtorëve Anargjendë të Verias, ndodhet një afresk që paraqet mrekullinë e “këmbës së zezë”. Sot, ikona të mrekullisë së “këmbës së zezë” mund të gjenden në shumicën e faqeve të para të librave më klasikë të transplantëve me komente mbi transplantin e parë të njohur dhe të suksesshëm, madje edhe nën referencën e një mrekullie”.

Një rast tjetër i mrekullisë së “këmbës së zezë”

Në kishën e ndërtuar nga Papa Feliksi në Romë për nder të dy

shenjtorëve Anargjendë, ishte dhe një roje, këmba e të cilit ishte gangrenizuar. Epitropi i devotshëm pa në ëndërr shenjtorët Kozma e Damian. Ata mbanin në duar vajra dhe kremra dhe diskutonin si ta shëronin atë. Njëri shenjtor tha: “Ku do të gjejmë mish të shëndetshëm që ta vendosim në vend të të kalburit?” Tjetri u përgjigj: “Sot u varros një arab në varrezat e Saint-Pierre-aux-Liens-it. Le t’i marrim atij një këmbë dhe t’ia vendosim epitropit”.

Të dy shenjtorët i vendosën epitropit këmbën e të vdekurit dhe, në vend të saj, kthyen në varr këmbën e të sëmurit. Epitropi u zgjua i shëruar. Vizionin dhe mrekullinë që i kishte ndodhur ua tregoi të gjithëve. Atëherë njerëzit vrapuan te varri i arabit dhe zbuluan se i mungonte një këmbë; në vend të saj ishte këmba e gangrenizuar.

Kisha Orthodhokse u lutet këtyre shenjtorëve: “O anargjendë mrekullibërës, shën Kozma dhe Damian, na vizitoni edhe na shëroni; falas morët, falas jepni”. (Përlëshorja)

Përgatiti: Miron Çako

Jeta është dhuratë

Në mëngjesin e 22 dhjetorit 1849, Dostojevskin e çuan për ta ekzekutuar në sheshin “Semionovski”, në Petërburg. Pikërisht në çastin që po i lexonin vendimin e gjyqit, instinktivisht në mendjen e tij kujtonte gjithë jetën e shkuar. U ekzekutuan tre të parët. Ai ndodhej në treshen pasardhëse. I kishin mbetur vetëm pesë minuta. Nga këto pesë minuta, llogarit kohën për të përshëndetur shokët, si dhe për të parë për herë të

fundit përreth. Dhe, kur i mbetën edhe rreth dy minuta kohë, i veçoi që të kujtonte për herë të fundit veten, të shkuarën e tij. Por fatmirësisht, në atë çast, ndërsa binin daullet dhe ai priste të dëgjonte urdhrin “Zjarr”, mbërriti një karrocë, nga e cila zbriti një oficer me një letër në dorë, në të cilën i falej jeta dhe i ndryshohej lloji i dënimit, nga dënim me vdekje, në katër vjet internim në Siberi. Kështu pra, e kthyen për-

sëri në kështjellën “Petropavlovsk”, nga ku e kishin marrë atë mëngjes.

Tashmë, i mbyllur brenda, pas një sprove të tillë, do t’i jepej sërisht rasti për të menduar të kaluarën e tij. Tani nuk do të ketë më vetëm disa minuta të numëruara, por ditë të tëra. Pikërisht, atë natë i shkruan vëllait të tij: “Kur shoh pas të kaluarën dhe mendoj se sa kohë humba me kotësi e me gabime; se si e humba

kohën time, pa ditur si të jetoj, e pa mundur ta çmoj kohën; kur mendoj se mëkatova ndaj vetes sime dhe shpirtit tim, atëherë zemra ime rënkon. Jeta, vëllai im, është një dhuratë, jeta është lumturi. Çdo minutë duhet të jetë një shekull lumturie. Tani, duke ndryshuar mënyrën e jetesës, rilindem në një njeri të ri.”

Marrë nga interneti: “Fotografitë që kanë bërë historinë”.

Qëndrimet e Kishave Orthodhokse për kthimin e “Shën Sofisë” në xhami

Patriarku i Antiokisë, Joani X, në një letër drejtuar Patriarkut Ekumenik:

Damask, 13 korrik 2020.

Me shumë keqardhje, morëm lajmin për vendimin e ri turk për të kthyer Kishën e Shën Sofisë në xhami. Ne jemi mërzhitur nga ky vendim. Denoncojmë dhe dënojmë me forcë çdo veprim që mund të falsifikojë identitetin historik.


Vendimi i fundit synon të marginalizojë praninë e krishterë në Lindje, për të mos thënë se ai përpiket të zhdukë rolin e mbetur pionier dhe praninë e krishterë në bashkëjetesë paqësore me pjesën tjetër të grupeve fetare. Historia përmban prova të bollshme të tolerancës dhe të vëllazërisë fetare në respekt të ndërsjellë. Ky vendim vjen për të minuar të gjitha përpjekjet e kryera nga vendet e zonës për të ndërtuar shtete të qytetarisë, që respektojnë diversitetin fetar dhe promovojnë vlerat pozitive të sekularizmit. Ky është një vendim që hap plagët dhe kështu, mjerisht, forcon ekstremizmin.

Shprehim shqetësimin tonë maksimal për thirrjet e fundit nga anëtarët e qeverisë turke, për të ndryshuar statusin aktual të “Shën Sofisë” nga muze në xhami.

Si administratorë të trashëgimisë së shenjtë në Jerusalem dhe në Tokën e Shenjtë, për afro 2000 vjet rresht, në një tokë mbi të cilën tri besimet Abrahamike hedhin pretendime të barabarta, vërtetojmë fuqimisht faktin se mirëkuptimi promovon paqen dhe respektin e ndërsjellë, ndërsa qëndrimet përjashtuese promovojnë konfliktin dhe hidhërimin. Shpresojmë dhe lutemi për të mirën e të gjithë njerëzve me vullnet të mirë, dhe për Turqinë si një komb me potencial, për të ndikuar në të gjithë rajonin tonë në një rrugë të rritjes dhe të bashkëjetesës së ndërsjellë, që të respektohet dhe të ruhet statusi aktual i “Shën Sofisë”.

Deklaratë e Sinodit të Shenjtë të Kishës së Qipros

Sinodi i Shenjtë i Kishës së Qipros, duke përfaqësuar edhe ndjenjat e zemëratës së popullit qipriot, si edhe të të gjithë Orthodhoksëve, shpreh pikëllimin e thellë dhe paralelisht shqetësimin,



për shkak të vendimit të fundit të autoriteteve turke për ta shndërruar “Shën Sofinë” e Konstandinopojës në faltore myslimane.

Për ne ky, akt i papeshuar dhe i paarsyeshëm, siç është thënë “do të çojë në një çarje të thellë midis Krishterimit dhe Islamit”... Zëri ynë i protestës është një thirrje agonie që u drejtohet organizmave ndërkombëtarë politikë dhe ndërkristianë, qeverive të vendeve, madje edhe Konferencës së Shteteve Islamike, për të ushtruar presion ndaj Turqisë, për të respektuar simbolin tashmë të shenjtë të të krishterëve të të gjithë botës...

Deklarata e Sinodit të Shenjtë të Kishës Orthodhokse Ruse, lidhur me vendimin e autoriteteve turke për ndryshimin e statusit të Shën Sofisë

Në seancën e mbajtur më 16-17 korrik 2020, Sinodi i Shenjtë i

Kishës Orthodhokse Ruse miratoi një deklaratë për këtë çështje:

Sinodi i Shenjtë i Kishës Orthodhokse Ruse shpreh keqardhjen e tij të thellë për vendimin e udhëheqjes shtetërore të Turqisë për të revokuar statusin si muze të “Shën Sofisë” dhe për t’ia

Krishtit, Shpëtimtarit, duke mbetur një kishë në vetëdijen e miliona të krishterëve. Dhe, për Kishën Orthodhokse, kjo katedrale ka një rëndësi të veçantë historike dhe shpirtërore.

...Shpresojmë që autoritetet turke të ndërmarrin hapat e nevojshëm për të ruajtur mozaikët e paçmuar të krishterë, të cilët kanë mbijetuar mrekullisht deri më sot dhe do të sigurojnë qasjen në to për pelegrinëve e krishterë.

Duke shprehur shpresën tonë për promovimin e mëtejshëm dhe forcimin e respektit dhe mirëkuptimit të ndërsjellë midis besimtarëve të feve të ndryshme botërore, ne gjithashtu i bëjmë thirrje komunitetit botëror të japë gjithë ndihmën e mundshme në ruajtjen e statusit të veçantë të “Shën Sofisë”, e cila ka rëndësi të përjetshme për të gjithë të krishterët.

Qëndrimi i Sinodit të Shenjtë të Kishës Bullgare

Sinodi i Shenjtë i Kishës Orthodhokse Bullgare - Patriarkana e Bullgarisë - ndjek me vëmendje dhe shqetësim diskutimet dhe vendimet e Këshillit Shtetëror dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë për ndryshimin e statusit të Kishës antike të krishterë “Shën Sofia” në Stamboll.

Si një faltore mijëra vjeçare për tërë Krishterimin dhe qendër shpirtërore e Orthodhoksisë, ky tempull është i dashur për çdo zemër të krishterë dhe përfaqëson një vlerë të jashtëzakonshme kulturore për të gjithë njerëzimin.

Kjo është arsyeja që ne bashkohemi me zërin tonë në thirrjet e Kishave Orthodhokse motra, si dhe të një numri udhëheqësish shtetërorë dhe institucioneve ndërkombëtare, për të ruajtur statusin aktual të “Shën Sofisë” si një muze dhe monument i Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s.

dhënë atë komunitetit mysliman për adhurim publik. Vendimi u mor pa marrë parasysh peticionet dhe qëndrimin e qartë të Primatëve dhe Hierarkëve të Kishave Lokale Orthodhokse, përfaqësuesve të shteteve të huaja, organizatave të shumta ndërkombëtare joqeveritare dhe të të drejtave të njeriut dhe klerikëve të besimeve të ndryshme dhe traditave fetare. Ajo ka dëmtuar ndjenjat fetare të miliona të krishterëve në të gjithë botën, të cilat mund të shkaktojnë shqetësim të ekuilibrit ndërfetar dhe të dëmtojnë mirëkuptimin e ndërsjellë midis të krishterëve dhe myslimanëve brenda dhe përtej Turqisë.

Në një kohë kur Krishterimi po përndiqet në shumë vende të planetit dhe vazhdon eksodi i të krishterëve nga vendet e Lindjes së Mesme, ky vendim i autoriteteve turke shkakton dhimbje të veçantë. “Shën Sofia” u ndërtua për nder të

“Shën Sofia” të mos bëhet sërish qendër përplasjesh

Letër e Këshillit Botëror të Kishave drejtuar Presidentit Erdogan për të ruajtur “Shën Sofinë” si trashëgiminë e përbashkët të njerëzimit

Gjenevë, 11 korrik 2020

Në një letër drejtuar Presidentit të Republikës së Turqisë, Shkëlqesisë së Tij Rexhep Taip Erdogan, Sekretari i Përgjithshëm aktual i Këshillit Botëror të Kishave, Rev. Prof Ioan Sauca, shpreh dëshirën dhe lutjen e tij të zjarrtë që “Shën Sofia” të mos bëhet sërish qendër përplasjesh dhe konfliktesh, por t’i rikthehet rolit të saj emblematik e unifikues, ashtu siç e ka pasur që prej vitit 1934. Në letër, ndër të tjera, thuhet:

I nderuar z. President,

...Në këtë ditë, jam i detyruar t’ju përcjell hidhërimin dhe shqetësimin e Këshillit Botëror të Kishave, si edhe të 350 kishave anëtare në më shumë se 110 shtete, që përfaqësojnë më shumë se gjysmë miliardi të krishterësh ane-

mbanë botës, për këtë nismë që doni të ndërmerrni. Duke vendosur ta shndërroni “Shën Sofinë” në një xhami, ju hidhni poshtë rolin pozitiv të Turqisë si një vend i hapur ndaj të gjithë botës, duke e kthyer atë në një vend të përjashtimit dhe ndasive. Gjithashtu, për fat të keq, ky vendim është ndërmarrë pa paralajmërim apo diskutime para-

prake me UNESCO-n, në lidhje me ndikimin që do të ketë ky vendim në vlerat universale të “Shën Sofisë”, të njohura nga Konventa e Trashëgimisë Botërore.

...Për më tepër, kemi frikë se ky vendim do të motivojë ambicinet e grupimeve të ndryshme, të cilat do të kërkojnë përmbysjen e status quo së ekzistuese, për të sjellë për-

çarje të reja midis komuniteteve fetare.

...Duke dashur të promovojmë mirëkuptimin e ndërsjellë, respektin, dialogun dhe bashkëpunimin, si dhe të shmangim thellimin e armiqësive dhe përçarjeve të vjetra, ju bëjmë thirrje urgjentisht për ta rimarrë në shqyrtim dhe për ta hedhur poshtë këtë vendim.

I bashkohemi Tërëshnjtërisë së Tij, Patriarkut Ekumenik Vartholome, për të shprehur dëshirën dhe lutjen tonë të zjarrtë që “Shën Sofia” të mos bëhet sërish qendër përplasjesh dhe konfliktesh, por t’i rikthehet rolit të saj emblematik e unifikues, siç e ka pasur që prej vitit 1934.

Me respekt,

Rev. Prof Dr Ioan Sauca,
Sekretar i Përgjithshëm i Këshillit Botëror të Kishave



Kthimi i “Shën Sofisë” në xhami u dënua dhe u kritikua gjerësisht

Nga Genc Pollo

Në prill të vitit 2009, asokohe zëvendës-kryeministër, kryesoja delegacionin shtetëror shqiptar në Forumin II Global të Aleancës së Civilizimeve, që mbahej në Stamboll. Kjo aleancë, që ndërkohë kishte marrë status zyrtar nga OKB-ja, ishte një iniciativë e vitit 2005, e Kryeministrit turk Erdogan dhe e atij spanjoll Zapatero dhe synonte tolerancë, mirëkuptim e bashkëjetesë jo thjesht paqësore, por mundësisht miqësore midis qytetërimeve, traditave kulturore e fetare të botës. Propozimi i saj vetëm katër vjet pas sulmit mbi Kullat Binjake në New York, profili i dy kryeministrave, si dhe elemente të tjera e bënin të qartë se në fokus ishte në radhë të parë raporti midis Europës e Perëndimit në njërin anë dhe shteteve me popullsi myslimane në anën tjetër. Çdo shtet pjesëmarrës do të adoptonte një plan kombëtar për të nxitur tolerancën, mirëkuptimin e bashkëjetesën miqësore.

Pas një viti e në vijim të kësaj fryme, me Stambollin si Kryeqytet European i Kulturës për vitin 2010, Kryeministri Erdogan deklaronte: “Ky është një qytet europian, me zemrën, kulturën e qytetërimin e tij, me njerëzit e tij, me të shkuarën e të ardhmen e tij ka parë gjithmonë drejt Europës. Stambolli ka formësuar kulturën europiane dhe është formësuar prej saj”.

10 vjet më vonë, po në Turqi, Këshilli i Shtetit anulon një dekret të Ataturkut që “Shën Sofinë”, kishën më të madhe e më të famshme të Konstandinopojës, të kthyer në xhami pas pushtimit osman në v. 1453, e shndërronte në një muze të hapur për të tërë. Po atë ditë, Presidenti Erdogan, me një dekret të posaçëm, ngarkon Dianetin, Komitetin për Çështjet Fetare, me rikthimin e Shën Sofisë në xhami, si dhe personalisht njofton ditën kur në të do të falet namazi i xhumasë. Akoma më tej, në versionin arabisht të deklaratës, zoti Erdogan shtoi një paragraf që mungonte në anglisht, ku shpallej

se hapi tjetër çlirimtar do të ishte për xhaminë Al Aksa në Jerusalem. Kjo e fundit është nën kontrollin e Izraelit dhe menaxhimin e Jordanisë.

Prej asaj dite debatohet nëse sekularizmi ataturkas i shek. XX ka më vend në Turqinë fetariste të shekullit të ri, nëse statusi muze a mos ishte profanimit për të dyja besimet dhe a mund të kishte përdorim dual të godinës së kultit. Gjithashtu, ngrihet pyetja nëse besimtarëve myslimanë në Turqi u nevojitej medoemos një xhami tjetër, kur ekzistueset janë të panumërta dhe vihet në dukje se edhe të krishterët, të paktë në numër, kanë shumë kisha funksionale në dispozicion. Por këto janë çështje për një shënim tjetër. Ajo që rëndon sot është se kthimi i “Shën Sofisë” në xhami u dënua e kritikua pothuaj nga të gjitha instancat në Europë, Perëndim e më gjerë, përfshi edhe nga përfaqësues turq e myslimanë, të cilët besojnë sinqerisht në tolerancën, mirëkuptimin dhe bashkëjetesën miqësore mes feve e kulturave.

Ky numër u konceptua me rastin e 240 - vjetorit të martirizimit të Shën Kozmait të Etolisë. Vonesa në botim ndodhi për shkak të pandemisë.

PËRMBAJTJA:

- Duke zbuluar moralin orthodhoks hierapostolik
Kryepiskopi i Tiranës, Durrësit dhe i Gjithë Shqipërisë, Prof. dr. Anastasi
- Hierapostullimi orthodhoks - Shën Kozma Etolosi
Kryepiskopi i Tiranës, Durrësit dhe i Gjithë Shqipërisë, Prof. dr. Anastasi
- Shën Kozmai, jeta dhe mësimi i tij
P. P. Pasku - Përzgjedhi atë A. Bendo
- Pikëpamjet shoqërore të Shën Kozmait të Etolisë
Prof. dr. Mikail Tritos
- Shën Kozmai i Etolisë dhe tradita arsimore
Prof. dr. Vasil Tushi
- Shën Kozmai i Etolisë - mësues dhe apostull i të krishterëve
Dr. Graham Speake
- Shën Kozmai i Etolisë në trevat e Mitropolisë së Gjirokastrës
Orfea Beci
- Jeta dhe vepra e Konstandin Kristoforidhit
Thoma Shkira
- Roli i familjes në shoqëri
Thoma Çomëni
- Familja si kishë në shtëpi
Motër Paisia
- Veprimtaria e Ateliesë së Fjonjatit në Shqipëri
Flora Marolli

KËRKKIM

REVISTË PERIODIKE. TEOLOGJI, SHKENCË, KULTURË, AKTUALITET



Ali Çashë Tepelena duke mbajtur në dorë lëpsarin e kokës së Shën Kozmait

KISHA ORTHODHOKSE AUTOQEFALE E SHQIPËRISË
TIRANË, 2019 - 2020

17



Duke kërkuar ndjesë për cilësinë e dobët të kësaj fotografie të shek. XIX, ajo është dëshmia, mbase e vetme, e manastirit të Shën Joan Theologut, në Voskopojë. Përballë tij ndodhej Akademia e famshme. Dihet se Voskopoja u dogj tri herë nga bejlerët lokalë, që e kishin halë në sy zhvillimin e kësaj qendre orthodhokse. Manastiri në foto u dogj nga bandat në vitin 1916.

Me rastin e 500-vjetorit të fjetjes

Shën Angelina

Nga Hirësi Joan Pelushi

(Botuar në gazetën "Ngjallja",
nëntor 1994)

Angelina ishte e bija e princit të famshëm shqiptar Gjergj Arianiti dhe e motra e Donikës, gruas së Heroit tonë Kombëtar, Gjergj Kastriotit. Princërit shqiptarë të mesjetës shqueshin edhe për lidhjet e tyre me kishat dhe manastiret. Të gjithë e dinë përkushtimin e familjes Kastrioti për manastirin e Hilandarit në Malin Athos. Po në atë manastir jetoj si murg orthodhoks vëllai i madh i Skënderbeut, Reposhi.

Familja e Arianitëve, që zotëronte territore të mëdha të Shqipërisë së Jugut, ishte një nga familjet më të dëguara ballkanase të Mesjetës. Ndaj, Gjergj Arianiti, një princ i shquar, që ishte një nga të parët që kishte mundur turqit, bëri krushqi me princërit më të dëguar orthodhoksë të kohës. Donika u martua me Gjergj Kastriotin, Angelina, vajza tjetër, u martua me despotin e Serbisë, Stefanin, krushqi e miratuar edhe nga princërit e tjerë shqiptarë.

Angelina u shqua që në fëmijëri për butësinë, mirësinë e zemërdhembshurinë e madhe që kishte ndaj të varfërve e nevojtarëve. Gjithmonë kishte dashur

të tërhiqej e të bënte një jetë të përkushtuar vetëm Zotit. I pëlqente vetmia dhe vizitonte shpesh kisha e manastire. Në atë kohë, Shqipëria ishte mbushur tërë kisha e manastire, ku jetonin qindra mësues të mëdhenj shpirtërorë. Thuhet se vetëm Kruja kishte pasur 365 kisha, të cilat u prishën nga pushtimi barbar osman. Ndoshta, një kujtim i këtyre kishave është thënia popullore në Krujë, që ky qytet ka 366 vende të mira. Ashtu ishte dhe malësia e Tiranës, e cila kishte kisha katedrale të panumërta, si katedralja e Shën Stefanit në Kllojkë etj.

Shumë qytete të Shqipërisë, tashmë të zhdukura, ishin të famshme për jetën fetare. Numrin 365 kisha në një qytet e gjejmë edhe në qytetet e tjera të Shqipërisë, gjë që tregon se sa i zhvilluar ishte Krishterimi në këtë pjesë të Ballkanit, dhe se çfarë dëmi të madh i solli pushtimi turk kombit tonë.

Përveç shkatërrimeve materiale, u shkatërrua edhe pasuria e madhe shpirtërore, e mbledhur ndër shekuj. U dogjën kronika e libra të pazëvendësueshëm për historinë e popullit tonë, u rrënuan mijëra kisha e manastire dhe, për më tepër, humbi identiteti dhe ideali për të cilin luftoi edhe princi më i famshëm

i popullit shqiptar në Mesjetë, Gjergj Kastrioti. Por le të kthehemi përsëri te shenjtorja jonë.

Edhe pasi u martua me despotin e Serbisë, Angelina bënte të njëjtën jetë, si më parë. Ndonëse princeshë, ishte e përlurur dhe e dashur me njerëzit e thjeshtë. Pushtimi turk e detyroi Stefan Brankoviçin, të birin e Gjergj Brankoviçit, dhe të shoqen, Angelinën, të merrnin rrugën e mërgimit.

Fillimisht ata erdhën në Shqipëri, pastaj shkuan në Itali. Edhe në mërgim, Angelina jetonte me devotshmëri e me frikë Perëndie. I rriti dhe i edukoi dy djemtë e saj, Joani dhe Maksimin, me një frymë të vërtetë të krishterë. Pas ndarjes nga jeta të të shoqit, Stefanit, ajo u bë murgeshë dhe iu përkushtua lutjeve, ndihmave për të varfrit dhe ndërtimit e restaurimit të kishave dhe manastireve. Një grua besnike, një nënë e mirë dhe një e krishterë e përsosur, ajo e meritoi emrin që i dha populli "Nënë Angelina".

Në vitin 1476, djali i saj, Joani, i rritur në Venedik, u bë përsëri despot i Serbisë. Sipas shembullit të nënës së tij, edhe ai iu përkushtua ndihmesës së kishave. Ndihoi manastiret në Malin Athos, në Shqipëri, Dalmaci e Banat. Joani ishte despoti i fundit i Serbisë dhe



është kanonizuar nga Kisha Orthodhokse.

Mbas vdekjes së të birit, Angelina shkoi në manastirin e Krushedolit, të cilin ajo vetë e kishte themeluar. Atje jetoj në përkushtim të plotë, me lutje, agjërim dhe ngritje shpirtërore të vazhdueshme. Fjeti në paqe në fillim të shek. XVI dhe u bashkua me Stefanin e drejtë dhe me dy bijtë e saj të devotshëm. Lipsanet e saj mrekullibërëse ruhen pranë lipsaneve të të shoqit dhe të të dy djemve, në manastirin e Krushedolit, ku ndërroi jetë. Lipsanet janë dëmtuar nga turqit.

Kisha Orthodhokse e nderon kujtimin e saj më 30 korrik.

Shën Angelina Shqiptare – Gruaja e një despoti serb që vdiq si murgeshë

Nga Prof. Dr. Valter Shtylla

Historia e Shqipërisë është e mbushur me ngjarje të ndryshme dhe, shpeshherë, mbresëlënëse. Në shumë prej tyre kanë qenë të pranishëm personazhe që tashmë njihen jo vetëm nga historia e Shqipërisë, por edhe nga historitë e vendeve të tjera. Një nga këto figura është edhe Angelina, bija e feudalit të njohur të shek. XV, Gjergj

Arianitit. Emri i gjatë i këtij të fundit ishte Gjergj Arianit Komnen Topia. Ai kishte dy vëllezër: Muzakë Komnenin dhe Vladanin. Ky i fundit ishte martuar me motrën e Skënderbeut, Angelinën me të cilën pati një djalë - Muzakun e Angelinës. Gjergj Arianiti ka jetuar me familjen e tij në Durrës dhe ka vdekur në fillim të vitit 1461. Ky feudal

shqiptar ishte ndër të parët prijës vendas që ngriti krye në fillim të shekullit XV kundër pushtimit turk...

Në lidhje me zotërimet e Gjergj Arianitit ka versione të ndryshme. Në një burim të Muzakajve thuhej se Gjergj Arianit Komnen Topia ka qenë zot i Çermenikës, i Mokrës e i Shpatit deri në lumin Devoll, ku

kjo pjesë ndahet nga zotërimet e Muzakajve. Nga martesja e parë e Gjergj Arianitit lindën tetë vajza. Vajza e madhe ishte Andronika ose Donika. Kjo vajzë, siç dihet, pati për burrë Gjergj Kastriot Skënderbeun, zotin e Dibërës, Matit dhe Krujës deri në bregdet. Gjergj Kastriot

(vijon në faqen 10)

(vijon nga faqja 9)

Skënderbeu dhe Donika lindën Gjonin. Ky u emërua Dukë i Shën Pjetrit në Galatinë dhe u martua me Dukeshën Erin Paleologa (Iriini), bijën e zotit të Serbisë, Llazarit.

Vajza e dytë e Gjergj Arianit Komnenit, Vojsava, u martua me Gjon Crnojeviçin, zot i Malit të Zi dhe i Zetës, me të cilin pati dy djem.

Objekti i këtij shkrimi është vajza e gjashtë e Gjergj Arianit Komnen Topisë, Angjelina. Angjelina u martua me një burrë shumë më të madh se vetja, i verbër ose pothuajse i verbër, despot i shfronësuar i Serbisë, i quajtur Stefan. Ky ishte njëri nga tre djemtë e despotit serb Gjergj Brankoviç, i cili, pa rënë në sy, por jo pa dinjitet, kishte ekzistuar midis hungarezëve katolikë dhe turqve, të cilët e patën vasal. Pas vdekjes së të atit, Stefani u shpall për pak kohë despot, për të humbur më pas përfundimisht pavarësinë. Stefani i verbër bëri shumë pelegrinazhe. Në njërin prej udhëtimeve të tij, atë që bëri në Shqipëri në vitin 1461, ai u njoh dhe u martua me Angjelinën, duke vendosur kështu lidhje familjare me Skënderbeun.

Më pas, me rekomandimin e Skënderbeut pranë Dukës së Milanos, ai u nis për në Itali ku në vitin 1472 përfundoi në Friuli. Në tetor të vitit 1476, Stefani vdiq. Në vitin 1478, Angjelina ndodhej në Vjenë, ku perandori Frederiku III e mori për zemër fatin e saj dhe i dhuroi një kështjellë në Karincia-Weissenfels.


Më pas, Angjelina u kthye në Itali, ku përsëri u ndihmua nga papa, siç dëshmohet nga Regjistrat Apostolikë, ndërmjet viteve 1479-84. Pas një përpjekjeje të komplikuar për shitjen e kështjellës së Belgradit në Pordenone/Itali, Angjelina me djemtë u transferua përsëri në Austri. Në saje të mbrojtjes nga perandori, bija e Angjelinës, Maria, u martua me një person me emër, me Markezin e Monferratës,

trashëgimtari i fundit i asaj dege të Paleologëve, e cila, që prej shek. XIV u zhvendos në Piemonte. Pas 1485-ës, Angjelina me djemtë u vendosën në kështjellën e Kupinovos, ishull në lumin Sava, ku sollën me vete edhe eshtrat e Stefanit, të cilat u bënë objekt pelegrinazhi për besimtarët orthodhoksë.

Më pas, i biri, despoti Gjergj, ndoshta i zhgënjyer nga dështimi i

punonte pranë Gjergj Brankoviçit, i cili më vonë pastaj u transferua në Peloponez, ndoshta me dhëndrin e Gjergjit, Tomas Kantakuzenin.

Më vonë, Maksimi (Gjergji) u kthye në Hungari dhe në vitin 1502 shkoi në Venecia me mision diplomatik në ndihmë të vëllait Gjon, i cili vdiq shpejt pas kësaj kohe. Angjelina dhe Maksimi jetuan akoma dhe shumë vjet në mana-



Lipsani i mbetur i shën Angjelinës, në manastirin e Krusedolit

martesës së tij me një napoletane fisnike, ardhur në Hungari pas Beatriçes së Aragonës, braktisi papritur kështjellën ku banonte dhe u vesh murg, duke marrë emrin Maksim. Djali i dytë, Gjoni, më luftarak, në vitet e mëvonshme mori pjesë në betejat kundër turqve, duke depërtuar disa herë në Bosnjë. Murgu Maksim me të ëmën, Angjelinën, që u bë murgeshë, dhe me eshtrat e të atit, shkoi në Vllahi, ku ndihmoi për organizimin e kishës lokale orthodhokse, duke bashkëpunuar, veç të tjerëve, dhe me ish-Patriarkun e Konstandinopojës, Nifonin, edhe ai me origjinë shqiptare. Ky i fundit ishte djalë i një shqiptari që

stirin e Krusedolit, ku edhe vdiqën. Angjelina vdiq si murgeshë në vitin 1516 për shkak të problemeve me shëndetin, kurse i biri, si mitropolit i Beogradit.

Malet Frushka Gora ndodhen ndërmjet lumenjve Danub dhe Sava, pranë qytetit Sremski Karlovac të Vojvodinës në Serbi. Në Frushka Gora ndodhen shumë manastire, ndërmjet të cilëve dhe Manastiri i fshatit Krusedol, i shtrirë në pjesën juglindore të maleve të përmendura. Ky manastir përfaqëson një kompleks ku përfshihen konakët dykatësh, që formojnë brinjët e një katrori në qendrën e të cilit është kisha me kabanoren. Manastiri i Krushe-

dolit njihet si qendër e përsëritshme e familjes së despotit Brankoviç. Ai u ndërtua ndërmjet viteve 1509 dhe 1516 nga zonja Angjelina, bija e Gjergj Arianit Komnen Topisë dhe gruaja e Stefan Brankoviçit, si edhe nga i biri, Gjergji (Maksim pas shugurimit). Për këtë ndërtim ndihmoi Vojvoda, vllah Jovan Njegoja. Në këtë manastir ndodhen eshtrat e Stefanit të Verbër, ato të shën Gjonit, përkatësisht babai dhe vëllai i Episkop Maksimit, eshtrat e Maksimit dhe ato të Nënë Angjelinës. Eshtrat e kësaj familjeje u ruajtën atje deri në vitin 1716, pra plot 200 vjet pas vdekjes së shën Angjelinës, deri kur manastiri u dogj e u dëmtua, duke pësuar humbje të konsiderueshme. Gjatë shekujve XVI-XVII, manastiri i Krusedolit u bë një qendër e njohur kishtarë. Gjatë viteve '40 të shekullit XVI u realizuan pikturat e para murale. Pas djegies së manastirit, rinovimi i kishës dhe i pikturës murale përfundoi në vitin 1745.

Kisha e sotme ka formë trekonkëshe me kupolë në qendër. Në ambientet e saj ruhet piktura murale me skenën e familjes ku janë pikturuar Gjergj Brankoviçi, Gjoni, Maksimi dhe Angjelina. Kjo pikturë është realizuar në vitin 1750 nga piktori ruso-ukrainas Jovan Vasiljeviç me financimin e tregtarit Racko Jovanoviç nga Novi Sadi i Vojvodinës. Veç kësaj, në ikonostasin e kishës së manastirit të Krusedolit, në rreshtin e poshtëm, djathtas Dyerve të Bukura, ndodhet ikona familjare ku shihen katër personat e kësaj kishe: Maksimi, Angjelina, Gjoni dhe Stefani i Verbër.

Historia e shën Angjelinës Shqiptare, bijës së prijësit të njohur shqiptar të shekullit XV, Gjergj Arianit Komnen Topisë, mishëron një nga historitë e shumta të figurave të spikatura të trevave shqiptare, të cilat presin të evidentohen dhe ndaj të cilave mendimi studimor shqiptar ndihet tepër i detyruar.

Marrë me shkurtime nga media



Elbasan 1909
Komisioni i shkolles Normale
Nga e majta lart-Ahmet Dakli, Qazim Hydi, Rrapush Demeti, Andon Bece
Ibrahim Bumci, Hasan Ciftja,
Ulur, nga e majta-Sheh Sheguni, Demal Karaosmani, Papa Janaqi.

Kisha Orthodhokse ka qenë gjithmonë në pararojën e edukimit dhe arsimimit të brezave të rinj. Kjo dëshmohej edhe nga kjo foto e vitit 1909, ku në komisionin e Shkollës Normale të Elbasanit është edhe prifti orthodhoks. Këtu duhet të kujtojmë faktin që edhe godina e parë e Normales u vu në dispozicion nga Komuniteti Orthodhoks.

Gjithnjë përkrah atyre që luftojnë për barazi dhe drejtësi

Kisha Orthodhokse, në tërësinë e saj në botë, ka qenë gjithmonë përkrah të gjithë atyre që kanë luftuar dhe luftojnë për barazi dhe drejtësi.

Në këtë foto historike paraqitet Kryepiskopi i Arki-dioqezës Greko-Orthodhokse të Amerikës (Patriarkana Ekumenike) Hirësia e Tij, Jakovi, përkrah pastorit Martin Luther King, që udhëhoqi marshimin kundër diskriminimit racial.



Gjatë atij marshimi, ai deklaroi përpara mediave: “Unë vij nga Turqia, ku isha qytetar i kategorisë së tretë. Ndaj, kur Martin Luther King-u ndërmori marshimin drejt gjykatës së Selmas, vendosa t’i bashkohesha atij, për të marrë revanshin kundër gjithë atyre që shtypin popullin.”

Kalendari i Liturgjive Hyjnore GUSHT 2020

1 E Shtunë † Dalja e Kryqit. 7 Makabejtë, Solomona etj. Oshdg. Elesa. *(Fillon Kreshma).*

2 E DIEL † 8 MT. (Shumimi i 5 bukëve). Transf. i lips. të Stefanit, dësh. I, kryedhjak.

6 E Enjte † # Metamorfoza (Shndërrimi i fytyrës) e Shpëtimarit Krisht (Sotirit).

9 E DIEL † 9 MT. (Jisui ecën mbi ujë). Ap. Matia. 10 dësh. në Portën e Bronztë.

15 E Shtunë † Fjetja e Hyjlindëses Mari. Dësh. Tarsizi në Romë.

16 E DIEL † 10 MT. (Shërimi i djalit epileptik). Peshqiri i Krishtit. Dësh. Alkiviadhi.

22 E Shtunë † Dësh. Agathoniku etj. Mbr/sha Ariadhni. Dëshg. Jona.

23 E DIEL † MBYLLJA E FJETJES. Hierod. Irineu i Lionit, Irineu i Sirmiumit.

24 E Hënë † Hierod. Kozma Etolosi, në Kolkondas (Fier). Hierod. Eftihi.

29 E Shtunë † * Prerja e kokës së Joan Pagëzorit. Ep. Arkadi i Arsinoit. *(Kreshmë)*

30 E DIEL † 12 MT. (I riu i pasur). Aleksandri, Pavli e Joani të Kon/pojës.



NGJALLJA

Organ i Kishës Orthodhokse
Autoqefale të Shqipërisë

Themelues:
Kryepiskopi Anastas

Del nën kujdesin
e Këshillit Botues

Kryeredaktor: Thoma Dhima

Adresa:

Qendra Sinodike,
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”,
Nr. 5, Tiranë

Tel: +355 4 2257261/2;

Fax: +355 4 2257263

E-mail: zyrashtypitkoash@gmail.com
orthchal@orthodoxalbania.org

Shtypur
në shtypshkronjën “Ngjallja”

Ceremonia e kthimit të "Shën Sofisë" në xhami



Kryemyftiu i mbështetur mbi shpatën e madhe: simbolikë dhe anakronizëm i rrezikshëm.

8 korrik - U kremtua shën Prokopi - shenjtori mbrojtës i kryeqytetit



Kisha e parë e Shën Prokopit, shenjtorit mbrojtës të Tiranës, u ndërta në vitin 1795, atje ku sot ngrihet Presidencia e Republikës.

Në vitin 1938, u shemb në kuadër të planit rregullues dhe u ndërta (1940-1945) mbi një kodër atje afër, duke i dhënë emrin gjithë zonës.

Në vitin 1960, kisha e Shën Prokopit u prish nga regjimi ateist-komunist dhe u kthye në klub. Në fillim të viteve '90, besimtarët orthodhoksë këmbëngulën që t'u kthehej kisha e tyre, madje edhe me protesta publike, derisa e rimorën dhe ajo u përshtat përsëri si kishë.

Më 8 korrik 2020, me rastin e së kremtes së shenjtorit, Hirësi Nathanaili kreu atje Liturgjinë Hyjnore bashkë me klerikë të kryeqytetit, në prani të besimtarëve të shumtë, që respektuan rregullat e distancimit social.



Kolegji Universitar "LOGOS", ofron programe studimi në:

FAKULTETIN EKONOMIK

- Bachelor në Financë-Kontabilitet
- Bachelor në Menaxhim Biznesi
- Bachelor në Menaxhim Turizmi
- Master Profesional në Financë - Kontabilitet

Programe studimi me karakter profesional me profile:

- Menaxhim i Fermës Bujqësore
- Marketing i Produktit Bujqësor

FAKULTETIN E SHKENCAVE TE APLIKUARA

- Bachelor në Informatikë e Zbatuar
- Bachelor në Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë
- Master Profesional në Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë

FAKULTETIN E SHKENCAVE HUMANE DHE KOMUNIKIMIT GJUHESOR:

- Bachelor në Teologji Sociale dhe Studime Religjioze
- Bachelor në Gjuhë dhe Civilizim Grek
- Bachelor në Mësuesi për Arsimin Parashkollor

Zgjedhja
juaj!

E-mail: info@kulogos.edu.al / Tel: +35569 30 30 277

www.kulogos.edu.al

Filluan regjistrimet !

Nëse mendoni se ju pëlqen muzika dhe jeni të talentuar, përdoreni talentën që ju është dhënë duke mësuar në Shkollën e Muzikës Bizantine dhe duke i psalur Zotit ashtu siç i ka hije.



Kritere

Kandidatët duhet të plotësojnë këto kritere:

- Të jenë të pagëzuar në Kishën Orthodhokse dhe të kenë marrë Certifikatën e Pagëzimit.
- Të kenë mbaruar Arsimin e Mesëm.
- Mosha: 18-45 vjeç.
- Letër rekomandimi nga Mitropoliti.
- Të kenë aftësi vokale dhe vesh muzikor.

Ne ju presim !



SHKOLLA E MUZIKËS BIZANTINE

Kontaktet:

Fb: Shkolla e Muzikës Bizantine
Youtube: Shkolla e Muzikës Bizantine
Email: shkollamuzikesbizantine@gmail.com
LinkedIn: School of Byzantine Music
Nr. tel: 069 263 6132
Vendodhja: Shkozë, Tiranë

